



REPUBLIKA E SHQI  
AVOKATI I POPU  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701481/11

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:** *Rekomandohet vendosja e kamerave në ambientin e observim-veçimit të IEVP Fier për të monitoruar disa hapësira që nuk mbulohen me pamje*

**Drejtuar:** Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z. Arben ÇUKO

**TIRANË**

**Për dijeni:** Drejtorit të IEVP Fier  
Z. Arjan HASANI

**FIER**

*I nderuar Zoti Çuko,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të dënuarit T. D., i cili pretendon se është dhunuar fizikisht në datën 14.11.2017 nga disa punonjës të grupit të sigurisë së IEVP Fier, në sektorin e observim-veçimit, fillimisht në dhomën e ndodhur përballë kollonës që përdoret nga punonjësit e policisë dhe më pas në një nga dhomat e veçimit.

Për verifikimin e kësaj ankese janë kryer disa veprime hetimore si: marrja e deklarimeve me shkrim nga disa të burgosur; administrimi i disa dokumentave; kqyrja e kamerave të sigurisë së IEVP Fier; kqyrja e ambienteve të observim-veçimit.

Në përfundim të hetimit, pasi analizuam në tërësi materialin e mbledhur, nuk u provuan pretendimet e të dënuarit T. D. se ndaj tij është ushtruar dhunë fizike.

Një nga veprimet hetimore të kryera ishte njohja me pamjet filmike të kamerave të sigurisë. Nga ky veprim u konstatua se, në ambientin e observim-veçimit të IEVP Fier janë vendosur tre kamera, të cilat nuk arrijnë të monitorojnë të gjithë koridorin. Hapësira e koridorit përballë disa dhomave të veçimit nuk monitorohet nga kamerat. Hapësira e koridorit në observim ku ndodhen dhomat 1, 3, 4, 13, 14 dhe 16 monitorohet pjesërisht nga kamerat edhe për shkak të një tablele të vendosur në tavan që zë pamjen e njëres prej kamerave. Hapësira e koridorit që

ndodhet ndërmjet kollonës dhe dhomës që përdoret nga punonjësit e policisë është tërësisht e pamonitoruar. Në këtë dhomë pretendohet se është ushtruar fillimisht dhuna fizike ndaj të dënuarit T.D.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha ambjenteve në IEVP, përveç atyre ambjenteve që çënojnë privatësinë, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambjenteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

### **REKOMANDOJMË:**

Vendosjen e kamerave në ambientin e observim-veçimit të IEVP Fier për monitorimin e hapësirave të lartpërmendura që nuk mbulohen me pamje;

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**